

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER  
SHKENCOR NË ARKITEKTURË-PROFILI ARKITEKT**  
DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS  
FAU-UPT

## Përmbajtje e rregullores

Neni 1 .....	3
BAZA LIGJORE.....	3
Neni 2.....	3
OBJEKTIVI I RREGULLORES.....	3
Neni 3.....	3
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	3
1. Emërtimi dhe lloji i programit.....	3
2. Departamenti/Fakulteti përgjegjës.....	3
3. Departamenti dhe Fakulteti bashkëpunues .....	3
4. Koordinator i programit.....	3
5. Kohëzgjatja e studimeve.....	3
6. Format e studimit .....	4
Neni 4.....	4
OBJEKTIVAT FORMUESE TË PROGRAMIT .....	4
Neni 5.....	4
NJOHURITË DHE KOMPETENCAT NË DALJE.....	4
Neni 6.....	5
PLANI MËSIMOR.....	5
Neni 7.....	5
SILABUSET E LËNDËVE .....	5
Neni 7.....	5
LISTA E DISIPLINAVE MËSIMORE SI DHE VEPRIMTARITË FORMUESES TË NDARA NË KREDITE .....	5
Neni 8.....	8
KRITERE DHE PROCEDURA SPECIFIKE PËR PRANIMIN E STUDENTËVE .....	8
Neni 9.....	9
ORGANIZIMI I STUDIMEVE .....	9
9.1 Krediti .....	9
9.2 Viti akademik.....	9
9.3 Gjuha e mësimdhënies.....	9
9.4 Grupi mësimor .....	10
Neni 10 .....	10
FORMAT E MËSIMDHËNIES .....	10
1. Seminari .....	11
2. Leksioni.....	11
3. Studio (atelier).....	11
4. Detyra/Projekti.....	11
5. Laboratori.....	11
6. Praktike Profesionale .....	11
7. Praktike Lëndore+Workshop .....	11
Neni 11 .....	11

FORMAT E PROVIME DHE VERIFIKIMI I DIJEVE .....	11
a) Kolekiumi.....	11
b) Kontrolli në lëndët “Studio” .....	11
c) Mbrojtja e projektit.....	11
d) Provimi/testi .....	11
Neni 12 .....	11
VLERËSIMI OSE SHLYERJA E STUDIOS (ATELIESË) SË PROJEKTIMIT .....	11
Neni 13 .....	12
DETYRIME SPECIFIKE QË LIDHEN ME FREKUENTIMIN.....	12
Neni 14 .....	13
FREKUENTIMI NË LËNDËT STUDIO.....	13
Neni 15 .....	14
KUSHTE, MODALITETE SPECIFIKE PËR TRANSFERIMIN E STUDENTËVE.....	14
Neni 16 .....	14
NJOHJA E KREDITEVE PËR PROCESA MËSIMORE JASHTË PROGRAMIT TË STUDIMIT.....	14
Neni 17 .....	14
ORGANIZIMI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE .....	14
Neni 18 .....	15
DIPLOMIMI.....	15

## Neni 1

### BAZA LIGJORE

Baza ligjore për hartimin e Rregullores së programit të studimit Master shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt përbëhet nga ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nen-ligjore që rregullojnë veprimtaritë mësimore e kërkimore në kuadër të një programi studimi, nga Statuti i Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular të Universitetit Politeknik të Tiranës

## Neni 2

### OBJEKTIVI I RREGULLORES

Objektiv i kësaj rregulloreje studimit është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për zhvillimin dhe menaxhimin e procesit mësimor-kërkimor që kryhet në kuadër të programit të studimit Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt.

## Neni 3

### TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

#### 1. Emërtimi dhe lloji i programit

Ky program studimi emërtohet “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” dhe është program i integruar i ciklit të dytë, i nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve

#### 2. Departamenti/Fakulteti përgjegjës

Njësia bazë përgjegjëse që ofron programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” është Departamenti i Arkitekturës, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës.

#### 3. Departamenti dhe Fakulteti bashkëpunues

Në këtë program studimi kontribuojnë nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës dhe ai i Urbanistikës, nga Fakulteti i Inxhinierisë Matematike e Inxhinierisë Fizike kontribuojnë Departamenti i Inxhinierisë Matematike dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit, Departamenti i Mekanikës së Strukturave, Departamenti i Gjeodezisë si dhe ai i Hidroteknikës dhe Hidraulikës, nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike Departamenti i Energjisë dhe ai i Menaxhim Prodhimit.

#### 4. Koordinator i programit

Procedurat e përzgjedhjes, mandati dhe kompetencat e koordinatorit të programit të studimit shprehen në rregulloren e Departamentit të Arkitekturës.

#### 5. Kohëzgjatja e studimeve

Programi i studimit Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt organizohet në 300 kredite, me kohëzgjatje normale në pesë vite akademike.

Studenti mund të përfundojë programin përkatës të studimeve edhe jashtë kohës normale të studimeve. Kohëzgjatja maksimale e studimeve nuk mund të jetë më shumë se dhjetë vite, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

## 6. Format e studimit

Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” është i organizuar në module të vlerësuara në kredite (ECTS). Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.

Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” përmbillet me punim diplome dhe në përfundim të tij lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e Arkitekturës.

## Neni 4

### OBJEKTIVAT FORMUESE TË PROGRAMIT

Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” synon formimin e profileve bashkëkohore të profesionisteve dhe studiuesve të rinj në fushën e Arkitekturës dhe Mjedisit të Ndërtuar, të aftë të përballen me sfidat që gjeneron konteksti Shqiptar, por edhe ato të një natyre me globale si zhvillimi i qëndrueshëm apo sfidat e globalizimit. Për arritjen e këtij objekti, gjatë viteve të studimit, studenti pajiset me njohuri shkencore e aplikative që lidhen me disiplinën e projektimit arkitektonik, përmes eksplorimit të tipologjisë e programit arkitektonik si instrumente didaktike. Në mënyrë progresive studenti njihet me shkallën e kompleksitetit që mbart projektimi i tipologjive arkitektonike, nga ato të banimit e deri tek strukturat kolektive e publike. Nga ana tjetër, në aspektin etik, studenti edukohet si një profil me impakt social e përgjegjësi kolektive. Arkitektura qaset si një disiplinë, produkti i së cilës është rrjedhojë e proceseve intelektuale e me impakt të ndjeshëm në dimensionin kulturor të vendit.

Në këtë program studimi studenti njihet me çështje teknike e teknologjike; bashkërendimi i zgjidhjes arkitektonike me sistemet konstruktive dhe me teknologjitë inovative në fushën e materialeve janë një aspekt tjetër i objektivave të këtij kursi studimi. Me rëndësi është njohja e dimensionit impiantistik e inxhinierik i të gjitha niveleve të një organizmi arkitektonik.

Në programin e studimit studenti merr njohuri lidhur me menaxhimin e procesit të ndërtimit, duke filluar nga hartimi i projektit, formulimi i kontratave, etika e zbatimit ligjet dhe rregulloret përkatëse, problemet e kantierit dhe sigurisë së tij, njohja me të gjitha fazat e punës deri në dorëzimin e objektit.

Në përfundim të këtij programi studimi, i diplomuari është në gjendje të analizoje probleme e të japë zgjidhje në terma hapësinore e arkitektonike, përmes një larmie instrumentesh, qofshin këto të natyrës digjitale apo dhe mjete klasike të projektimit.

## Neni 5

### NJOHURITË DHE KOMPETENCAT NË DALJE

Në përfundim të ciklit pesë-vjeçar të studimeve në këtë program studimi studenti:

- a) Fiton njohuri të thella në lëndët e formimit të përgjithshëm të arkitektit si: matematike, gjeometri deskriptive, gjuhë e huaj, grafikë+modelim, grafikë+CAAD, si dhe të jenë në gjendje të përdorin këto njohuri për të interpretuar problemet në projektimin arkitektonik.
- b) Fiton njohuri të plota në bazat e vizatimit dhe projektimin arkitektonik, në kompozicion dhe analizë forme, në projektim urbanistik dhe urbanistike teknike, në materialet e ndërtimit dhe

teknologjisë së tyre, njohuri lidhur me historinë e arkitekturës si dhe teorinë e arkitekturës dhe urbanistikës.

- c) Merr njohuritë e nevojshme për të kryer pune kërkimore të pavarur, qoftë në funksion të problemeve të praktikës profesionale, qoftë në funksion të niveleve më të thelluara të studimeve.
- d) Përvetëson rregullat e projektimit ambiental, adaptimit arkitektonik, peizazhit, restaurimit të monumenteve të kulturës, arkitekturës së interiorit, legjislacionit ark-urb, topografisë, rregullat e llogaritjes konstruktive të objekteve si dhe të ekonomisë apo organizimit tëDo punimeve.
- e) Do të jetë në gjendje të realizojë zbatimin e këtyre punimeve edhe në koordinim me specialiste të tjerë si në fushat e urbanistikës, inxhinierisë së ndërtimit, gjeodezisë, mjedisit etj.

## Neni 6

### PLANI MËSIMOR

Plani mësimor i programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” pasqyron periudhën kohore të organizimit të secilës nga disipinat dhe veprimtaritë formuese të programit, ngarkesën e tyre në ECTS, orë në auditor dhe orë pune individuale, të ndara sipas viteve akademike, sipas formatit të bashkëlidhur në aneks të këtij dokumenti.

## Neni 7

### SILABUSET E LËNDËVE

1. Programet mësimore të lëndëve hartohen për çdo disiplinë të planit mësimor të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” . Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, në silabusin e lëndës jepen në formë të përmbledhur:

- a) të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e lëndës, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor, emri i titullarit të lëndës dhe i stafit mësimdhënës;
- b) njohuritë paraprake që duhet të ketë fituar paraprakisht studenti, objektivat formuese të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvetësimi i lëndës, konceptet dhe termat bazë mbi të cilat ndërtohet lënda;
- c) përmbajtja e lëndës, e ndarë në leksione dhe ushtrime/seminare, e detajuar në tematika që zhvillohen sipas javëve mësimore;
- d) përmbajtja e punëve laboratorike, praktikave lëndore, temat e detyrave/projekteve të kursit;
- e) forma e kontrollit që do të përdoret, parakushtet e hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse.

2. Silabuset e lëndëve të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” janë objekt i rishikimit periodik në përputhje me procedurat e përshkruara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të UPT-së dhe në Rregulloren e Departamentit të Arkitekturës.

## Neni 7

### LISTA E DISIPLINAVE MËSIMORE SI DHE VEPRIMTARITË FORMUESES TË NDARA NË KREDITE

1. Në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt”, veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- a) lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
- b) lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
- c) lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disjplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;
- d) lëndë plotësuese, të fokusuara në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;
- e) detyrime përmblyëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.

Tabela e mëposhtme jep veprimtaritë formuese sipas kategorive të sipërme dhe përqindjen e tyre në raport me totalin e krediteve të planit mësimor në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Tipi i lëndës	Emërtimi	Kredite	Leksion	Seminar	Det /Projekt	Lab	Prakt
A	Matematikë 1	3.0	1.5	1.5			
A	Gjeometri deskriptive 1	5.0	3.0	2.0			
A	Vizatim i lirë dhe histori arti	6.0	1.0	4.0	1.0		
A	Grafikë arkitektonike	4.0	1.0	3.0			
A	Matematikë 2	3.0	1.5	1.5			
A	Histori arkitekture 1	6.0	4.0	0.5	0.5		1.0
A	Gjeometri deskriptive 2	4.0	2.0	2.0			
A	Elemente ndërtesash	5.0	2.5	2.0	0.5		
A	Grafikë arkitektonike	4.0	1.0	3.0			
A	Komunikim grafik - CAAD1	3.0	1.0	2.0			
A	Histori arkitekture 2	5.0	3.0	1.0			1.0
A	Komunikim grafik - CAAD2	3.0	1.0	2.0			
A	Histori arkitekture 3	3.0	2.0		1.0		
A	Fizikë teknike	6.0	4.0	2.0			
	TOTAL KREDITE	60.0					
B	Evolucioni I ambientit të ndërtuar / Analizë qyteti dhe territori	4.0	2.0	1.0	1.0		
B	Bazat e projektimit arkitektonik	8.0	2.0	5.0			1.0
B	Kompozicion, analizë forme e hapësire	4.0	1.5	2.0	0.5		
B	Studio arkitekture 1	8.0	1.0	7.0			
B	Teknologji arkitekture 1	5.0	1.5	3.0	0.5		
B	Kompozicion, analizë forme e hapësire	4.0	1.5	2.0	0.5		
B	Studio arkitekture 2	8.0	1.0	7.0			
B	Teknologji arkitekture 2	5.0	1.0	3.0			1.0

Rregullore e programit të studimit MSHA-Profilu Arkitekt  
 Departamenti i Arkitekturës 2020  
 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

<b>B</b>	Bazat e projektimit urban dhe elemente të peizazhit	7.0	2.0	4.0	1.0		
<b>B</b>	Teori arkitekture e urbanistike	6.0	3.5	2.0	0.5		
<b>B</b>	Studio arkitekture 3	8.0	1.0	7.0			
<b>B</b>	Teknologji arkitekture 3	6.0	2.0	4.0			
<b>B</b>	Rilevim arkitektonik dhe topografi	4.0	2.0	1.0	1.0		
<b>B</b>	Studio arkitekture 4	8.0	1.0	7.0			
<b>B</b>	Urbanistikë 1	8.0	2.0	4.0	1.0		1.0
<b>B</b>	Studio arkitekture 5	8.0	1.0	7.0			
<b>B</b>	Projektim ambiental	4.0	1.0	3.0			
<b>B</b>	Restaurim i monumenteve të kulturës	4.0	1.0	2.0			1.0
<b>B</b>	Gjenezat e mendimit bashkëkohor në arkitekturë	5.0	2.5	2.0	0.5		
<b>B</b>	Studio arkitekture 6	8.0	1.0	7.0			
<b>B</b>	Urbanistikë 2	7.0	1.0	5.0			1.0
<b>B</b>	Projektim ambiental	4.0	1.0	3.0			
<b>B</b>	Restaurim i monumenteve të kulturës	4.0	1.0	3.0			
<b>B</b>	Studio arkitekture 7	8.0	1.0	7.0			
<b>B</b>	Arkitekturë interieri	7.0	1.0	5.5	0.5		
<b>B</b>	Adaptim arkitektonik	7.0	1.0	5.5	0.5		
<b>B</b>	Metoda të kërkimit të aplikuar në arkitekturë	5.0	1.0	4.0			
	<b>TOTAL KREDITE</b>	164.0					
<b>C</b>	Materiale ndërtimi	3.0	1.5	1.0		0.5	
<b>C</b>	Shkencë konstruksioni 1	5.0	2.0	2.0	1.0		
<b>C</b>	Shkencë konstruksioni 2	4.0	2.0	1.5	0.5		
<b>C</b>	Impiante ndërtesash	6.0	4.0	1.0	1.0		
<b>C</b>	Konstruksione ndërtimi 1	4.0	2.0	1.5	0.5		
<b>C</b>	Konstruksione ndërtimi 2	4.0	2.0	1.5	0.5		
<b>C</b>	Konstruksione ndërtimi 3	4.0	2.0	1.5	0.5		
<b>C</b>	Legjislacion	3.0	2.0	1.0			
<b>C</b>	Lëndë me zgjedhje	5.0	2.5	2.0	0.5		
	<b>TOTAL KREDITE</b>	38.0					
<b>D</b>	Gjuhë e huaj	5.0	1.0	3.0	1.0		
<b>D</b>	Komunikim grafik - CAAD3	5.0	2.0	2.0	1.0		
<b>D</b>	Kërkim shkencor dhe Shkrim Akademik	3.0	1.5	1.0	0.5		
<b>D</b>	Praktikë profesionale	10.0					10.0
	<b>TOTAL KREDITE</b>	23.0					
<b>E</b>	Diploma arkitekt	15.0					

2. Raportet e sasisë së krediteve të lëndëve sipas tipologjive jepen në tabelën që vijon:

Tipi	Nr. i disiplinave	Kredite	Përqindje në raport me totalin	VKM 41
<b>A</b>	14	60	20.0 %	15-20 %
<b>B</b>	27	164	54.7 %	45-55 %
<b>C</b>	9	38	12.7 %	12-15 %



<b>D</b>	4	23	7.7 %	6-8 %
<b>E</b>	1	15	5.0 %	3-5 %

3. Në këtë plan mësimor, ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, është përcaktuar, në bazë të ndarjes së krediteve të lëndës për secilin komponent mësimor të saj dhe orëve që i alokohen çdo krediti, të miratuar nga Senati Akademik i UPT-së. Tabela në vijim jep zberthimin e kreditit sipas veprimtarive mësimore:

Aktiviteti	Nr. krediteve	Cikli i pare Bachelor Orë auditor	Cikli i pare Bachelor Orë stud. indiv	Cikli i dytë MSc, MP Orë auditor	Cikli i dytë MSc, MP Orë stud. indiv
<b>Leksion</b>	1 kredit	<b>12</b>	13	<b>10</b>	<b>15</b>
<b>Ushtrime/Studio</b>	1 kredit	<b>14</b>	11	<b>12</b>	<b>13</b>
<b>Laborator</b>	1 kredit	<b>20</b>	5	<b>20</b>	<b>5</b>
<b>Projekt/detyra</b>	1 kredit	<b>5</b>	20	<b>5</b>	<b>20</b>
<b>Praktika</b>	1 kredit	<b>23</b>	2	<b>23</b>	<b>2</b>
<b>Diploma</b>	<b>1 kredit</b>	<b>5</b>	<b>20</b>	<b>10</b>	<b>15</b>

4. Plani mësimor i programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” është objekt i rishikimit periodik në përputhje me procedurat e përshkruara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të UPT-së dhe në Rregulloren e Departamentit të Arkitekturës.

## Neni 8

### KRITERE DHE PROCEDURA SPECIFIKE PËR PRANIMIN E STUDENTËVE

1. Pranimi në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” është i mundur për çdo kandidat, i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ose zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, si ekuivalente me të dhe që plotëson kriterin/kriteret shtetërore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
2. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt”, si dhe procedurat specifike për përzgjedhjen e tyre përshkruhen në rregulloren mbi “Kriteret e pranimit në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve në profilin arkitekturë, urbanistikë dhe në programin e ciklit të parë të studimeve në arkitekturë interieri dhe dizajn”.

## Neni 9

### ORGANIZIMI I STUDIMEVE

#### 9.1 Krediti

1. Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” është i organizuar në module të vlerësuara në kredite (ECTS). Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.
2. Një krediti të formimit të arsimit të lartë i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit (1 orë mësimore pune llogaritet 60 minuta). Sasia mesatare e punës së kryer nga studenti gjatë një viti studimesh universitare me kohë të plotë është 1500 orë mësimore (60 kredite), që përfshijnë orë në auditor dhe orë punë të pavarur.
3. Orët e punës së pavarur të studentit, zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është nga 20 deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe.
4. Studenti fiton kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese si: lëndë, praktikë, diplomë, etj., vetëm në rastin e një vlerësimi pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tij. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).
5. Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” përmbillet me punim diplome dhe në përfundim të tij lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e Arkitekturës.

#### 9.2 Viti akademik

1. Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” zhvillohet në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë. Viti akademik përfshin mësimdhënien, sesionin e provimeve, sesionin e mbrojtjes së diplomave. Mësimdhënia organizohet në dy semestra. Kohëzgjatja e një semestri është deri në 14 javë.
2. Organizimi i mësimdhënies, i sesionit të provimeve dhe i sesionit të mbrojtjes së diplomave, shprehet në strukturën mësimore, e cila miratohet dhe shpallet nga Rektori i UPT-së në fillim të çdo viti akademik.

#### 9.3 Gjuha e mësimdhënies

1. Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” ofrohet në gjuhën shqipe.
2. Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare apo për pjesë të veçanta të programit, mund të përdoret gjuha angleze. Literatura e rekomanduar mund të jetë në gjuhën angleze.

#### 9.4 Grupi mësimor

1. Puna mësimore zhvillohet mbi bazë grupi mësimor. Numri maksimal i studentëve në grupet mësimore, në varësi të aktivitetit mësimor, respekton përcaktimet e rregullores së zhvillimit kurrikular të UPT-se, si më poshtë:

Nr i studentëve/ seminar	Nr i studentëve/ laborator	Nr i studentëve/ praktika	Nr i studentëve/ lëndët studio (FAU)	Nr i studentëve/ leksion
25	20	20	10-15	deri në 6 grupe seminari (150)

### Neni 10

#### FORMAT E MËSIMDHËNIES

1. Puna mësimore brenda këtij programi studimi zhvillohet konform formave të mësimimit dhe të kontrollit të dijeve të përshkruara në Rregulloren e zhvillimit Kurrikular të UPT-së. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes raporteve të caktuara, të parashikuara në planet mësimore, në programet e lëndëve dhe në rregulloren mësimore të programit të studimit. Në Universitetin Politeknik format kryesore të punës mësimore janë:
  - a. Format e mësimimit teorik e praktik, ku përfshihen: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, ateljetë, projekt – diplomat, etj.
  - b. Format e kontrollit të dijeve, ku përfshihen: bashkëbisedimet, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, etj.
2. Për programin e i integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt”, format e mësimdhënies janë si vijojnë:

1. Seminari
  2. Leksioni
  3. Studio (atelier)
  4. Detyra/Projekti
  5. Laboratori
  6. Praktike Profesionale
  7. Praktike Lëndore
  8. Punëtori/projekte jashtë-kurrikulare në kuadër bashkëpunimesh
3. Format të tjera të mundshme alternative të mësimdhënies për këtë program studimi përshkruhen në silabuset e lëndëve dhe propozohen e miratohen sipas procedurave të përshkruara në rregulloren e zhvillimit kurrikular të UPT-së.

## Neni 11

### FORMAT E PROVIME DHE VERIFIKIMI I DIJEVE

1. Në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt”, për të vlerësuar njohuritë e studentit, përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Nota minimale kaluese është 5 (pesë).
2. Në rastin e organizimit të disiplinave me module, vlerësimi realizohet nëpërmjet provimit të integruar për të gjithë lëndën, ose shlyerjen me pjesë të lëndës sipas moduleve. Në të dyja rastet vlerësimi i tezës bëhet me pikë dhe vlerësimi përfundimtar do të shprehet nëpërmjet një note mesatare të ponderuar, ku merret në konsideratë pikët dhe kreditet për çdo pjesë të shlyer.
3. Në programin e lëndës/modulit shprehen mënyrat e vlerësimit të saj, të cilat i bëhen të njohura studentit me fillimin e procesit mësimor.
4. Format e kontrollit të dijeve të aplikuara në këtë program studimi janë si vijojnë:
  - a) Kolekiumi
  - b) Kontrolli në lëndët “Studio”
  - c) Mbrojtja e projektit
  - d) Provimi/testi
5. Kushtet, modalitetet e zhvillimit si dhe pesha në vlerësimin përfundimtar të secilës forme kontrolli përcaktohen në silabuset e lëndëve dhe miratohen sipas procedurave të përshkruara në rregulloren e zhvillimit kurrikular të UPT-së

## Neni 12

### VLERËSIMI OSE SHLYERJA E STUDIOS (ATELIESË) SË PROJEKTIMIT

Studio/atelier është një formë mësimdhënieje e aplikuar në lëndë me karakter thellësisht profesional e formues në këtë program studimi, ku instrumenti kryesor i dhënies dhe përcimit të dijes është

projekti, si produkt final i një procesi që imponon angazhim intelektual, teorik e praktik të studentit, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e pedagogut.

Procesi mësimor kryhet përmes konsultës individuale mes pedagogut e studentit, sesioneve të debateve/diskutimeve/ushtrimeve në grupe të reduktuara studentesh, apo edhe ligjërimeve në nivel grupi mësimor.

1. Vlerësimi përfundimtar në lëndët me karakter studio bazohet në katër komponentë:

- a) Vlerësimi projektit të kursit
- b) Vlerësimi i formimit teorik
- c) Vlerësimi i praktikës mësimore
- d) Frekuentimi dhe aktivizimi

Ku:

- a) Vlerësimi i projektit të kursit, bazohet në ecurinë e punës së studentit gjatë realizimit të programit të lëndës si dhe në analizën dhe cilësinë e projektit përfundimtar. Gjatë procesit të projektimit gjatë një moduli, studenti do të nënshtrohet konsultimeve dhe kontrolleve të detyrueshme, të cilat vlerësohen nga pedagogu i lëndës ose komisionet e ngritura. Vlerësimi pozitiv i kontrolleve është kusht i domosdoshëm për dorëzimin e projektit të kursit. Projekti i kursit dorëzohet me mbrojtje të hapur përballë jurisë / komisionit.
  - b) Vlerësimi i formimit teorik, realizohet me anë të provimit me shkrim ose me gojë, gjatë ose pas dorëzimit të projektit të kursit dhe vlerësimit pozitiv të tij.
  - c) Vlerësimi i praktikës realizohet me mbrojtje (Shlyerje).
  - d) Frekuentimi e aktivizimi vlerësohen bazuar në performancën e shfaqur nga studenti gjatë procesit mësimor.
2. Peshat e secilit komponent në raport me vlerësimin përfundimtar përcaktohet në silabuset e lëndëve.
3. N.q.s. studenti plotëson 75% frekuentimit, por nuk fiton të drejtën për të dorëzuar projektin (sepse s'ka fituar kontrollet), shpallet përsëritës nga sekretaria mësimore dhe i shënohet emri në regjistrin e përsëritësve për vitin pasardhës.

## Neni 13

### DETYRIME SPECIFIKE QË LIDHEN ME FREKUENTIMIN

Shlyerja e frekuentimit të një moduli respekton përcaktimet e rregullores kurrikulare të UPT-se, si vijon:

1. Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies së disiplinave të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme e frekuentimit të tyre ndryshon në funksion të tipit të aktivitetit mësimor që realizohet, duke i klasifikuar pjesërisht të detyrueshme dhe plotësisht të detyrueshme.
  - a. Frekuentimi i leksioneve nuk është i detyrueshëm, ndërsa frekuentimi i seminareve dhe ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75% të numrit të seanceve të zhvilluara.

- b. Frekuentimi i punëve laboratorike, punëve praktike dhe praktikave mësimore është plotësisht i detyrueshëm në masën 100%.
2. Për format e mësimimit me frekuentim të detyruar, të pjesshëm, kur studenti me ose pa arsye, nuk merr pjesë në mbi 25% të numrit të seancave të zhvilluara në një lëndë, shpallet i paklasifikuar dhe nuk lejohet të shlyejë detyrimet e mëtejshme të asaj lënde. Ai është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimimit në vitin pasardhës, me të njëjtën detyrë frekuentimi.
3. Për formën e mësimimit me frekuentim të detyrueshëm laborator dhe praktikë mësimore/profesionale në terren, kur studenti me ose pa arsye nuk merr pjesë qoftë edhe në një seancë mësimi, departamenti përkatës i krijon studentit edhe një mundësi tjetër për të shlyer frekuentimin e detyruar, para përfundimit të semestrit. Në rastet e përsëritjes së mungesave, studenti i ndjek ato në vitin pasardhës.

## Neni 14

### FREKUENTIMI NË LËNDËT STUDIO

1. Në rastin e praktikës mësimore të përfshirë në atelietë e projektimit frekuentimi është i detyrueshëm me shlyerje. Masa e frekuentimit dhe konsultimit të tyre përcaktohet nga departamenti në planin mësimor të lëndës dhe i bëhet me dije studentit para fillimit të vitit akademik. Në rast se studenti nuk ka përmbushur numrin e caktuar të prezencës 75% të orëve dhe konsultimeve (shlyerjen e të gjitha kontrolleve), ai duhet të përsëris lëndën me brezin që vijon pas tij, duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet e kurrikulës dhe organizimit të studimeve që mund të kenë ndodhur në brezin të cilit ai i bashkohet. Më poshtë do të radhiten lëndët profesionale të cilat kanë detyrim frekuentimi dhe konsultimi.

- *Grafikë Arkitektonike*
- *Bazat e Projektimit Arkitektonik*
- *Teknologji Arkitekturë 1,2,3*
- *Vizatim i lirë dhe histori arti*
- *Urbanistikë 1,2*
- *Studio Arkitekturë 1,2,3,4,5,6,7*
- *Projektim Ambiental*
- *Projektim Interieri*
- *Bazat e projektimit urban dhe elemente të peizazhit*
- *Restaurim monumenteve të kulturës*
- *Adaptim Arkitektonik*

2. Për studentet që realizojnë frekuentimin dhe kontrollet përkatëse të projektit dhe vlerësohen me notë pakaluese (4 katër) në projekt, ose që nuk arrijnë të realizojnë dorëzimin e projektit në fund të modulit, kanë të drejtë të bëjnë dorëzim deri në sezonin e riprovime në vjeshtën e vitit pasardhës. Në rast se deri në këtë kohë studenti nuk shlyen projektin, atëherë kjo pjesë e lëndës kalon në frekuentim të detyrueshëm.

3. Nuk lejohet që studenti të mbartë projektin në 2 vite të njëpasnjëshme.

## Neni 15

### KUSHTE, MODALITETE SPECIFIKE PËR TRANSFERIMIN E STUDENTËVE

1. Procedurat për transferimin e studimeve fillojnë në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë së fundi i javës së dytë të semestrit të parë.
2. Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt”, bëhet nga Departamenti i Arkitekturës, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit kurrikular të UPT-së dhe rregullore së Departamentit të Arkitekturës.
3. Lënda ose moduli në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt” ekuivalentohet kur:
  - a) ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm me lëndën/modulin e programit të studimit ku transferohet;
  - b) trajton tema të njëjta ose të ngjashme dhe ka përputhje të ngarkesës në auditor në masën mbi 70% të lëndës/modulit që zhvillohet në programin e studimit në UPT.

## Neni 16

### NJOHJA E KREDITEVE PËR PROCESË MËSIMORE JASHTË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Njohja e krediteve të marra nga një student, jashtë programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt”, në kuadër të bashkëpunimeve institucionale ndërkombëtare apo kombëtare (programet Erasmus etj) bëhet nga Departamenti i Arkitekturës, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit kurrikular të UPT-së dhe rregullore së Departamentit të Arkitekturës.

## Neni 17

### ORGANIZIMI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE

1. Në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt”, praktika profesionale është e parashikuar me një ngarkesë prej 10 kreditesh. Procedurat e zhvillimit të saj janë në përputhje me përcaktimet e rregullore së zhvillimit kurrikular të UPT-së.
2. Këshilli i Programit të Studimit (KPS) dhe Koordinatori i Programit të studimit, janë përgjegjës për evidentimin, angazhimin dhe zgjerimin e kompanive/institucioneve për realizimin e Praktikave Profesionale. Koordinatori i KPS-së përditëson data bazën e kompanive/institucioneve që ka bashkëpunim dhe ja dërgon elektronikisht një muaj para fillimit të praktikës drejtuesit të Departamentit të Arkitekturës. Praktikave profesionale zhvillohen në kompani/institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga Departamenti i Arkitekturës.

3. Departamenti i Arkitekturës mban përgjegjësi për kryerjen e praktikës profesionale. Përgjegjësi i Departamentit përcakton pedagogët përgjegjës të cilët do të drejtojnë praktikën profesionale. Pedagogu përgjegjës përpilon “Programin e praktikës” i cili miratohet nga Drejtuesi i Departamentit.
4. Departamenti bën ndarjen e studentëve nëpër kompani/institucione pritëse, duke respektuar edhe propozimet e tyre. Lista e studentëve me pedagogun përgjegjës dhe kontratat e praktikës profesionale (bazuar në modelin-tip të dërguar nga drejtoria juridike e institucionit) i dërgohen për firmë Dekanit të fakultetit. Në rast kur kompania/institucioni pritës angazhohet për herë të parë në praktikë profesionale Rektori i UPT’ së lidh marrëveshje bashkëpunimi, deri një javë para fillimit të praktikës.
5. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës profesionale. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e kompanisë/institucionit pritës.
6. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, pedagogu përgjegjës që e drejton atë, mban lidhje me kompaninë/institucionin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer i cili vlerësohet nga komisioni i ngritur në departament. Vlerësimi bëhet me notë.
7. Në rastet kur studenti për arsye objektive nuk shlyen detyrimet për praktikën mësimore, Departamenti, mbështetur në kërkesën e studentit (depozituar në Departament) mund t’i japi të drejtën për rikryerjen e praktikës mësimore deri në fund të vitit akademik.

## Neni 18

### DIPLOMIMI

1. Procedurat e kryerjes së procesit të diplomimit në këtë program studimi kryhen konform përcaktimeve të rregullores së zhvillimit kurrikular të UPT-së, Rregullores së Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si dhe Rregullores së Departamentit të Arkitekturës. Ky nen vendos rregullat normative të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve të përfshira në procesin e diplomimit, të cilat përcaktojnë të drejtat e detyrimet e diplomantëve, rregullat për organizimin e procesit si dhe raportet e tyre me organet drejtuese dhe strukturat e tjera të FAU. Pikat e këtij neni kanë për qëllim të sigurojnë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit të diplomimit, të sigurojnë rregulla të njëjta për disiplinën studentore dhe administrative, si dhe të garantojnë standarde të cilësisë në hartimin e tezës së diplomës
2. Në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor në Arkitekturë-Profil Arkitekt”, lënda “Studio Diplome” zhvillohet në semestrin e 10-të të vitit të V-të të studimeve.
3. Parakushte të marrjes së temës së Diplomës

Parakushte të marrjes së temës së Diplomës

**Studenti duhet të ketë shlyer frekuentimin në modulin “Metoda të kërkimit të aplikuar në arkitekturë” (K1) në mënyrë që të ndjekë Studion e Diplomës në semestrin X.**



**Studenti duhet të ketë fituar minimumi 180 kredite nga tre vitet e para dhe 75 kredite nga viti i katërt dhe i pestë në mënyrë që të mund të marrë temën e diplomës dhe të ndjekë Studio e Diplomës në semestrin X.**

4. Aspekte didaktike

**Një Kredit Diplomë në Programin e Studimit M.Sh. në Arkitekturë (Profili Arkitekt) është i barabartë me 5 orë në auditor dhe 20 orë punë individuale e studentit.**

- Orët në Auditor:  $5 \times 15 = 75$  orë gjithsej në auditor

- Orë të zhvilluara nga udhëheqësi: 20 orë

- Orët në auditor të zhvilluara nga Studio e Diplomës:  $75 - 20 = 55$

- Kontrolli përfundimtar i diplomës: 7 orë

- Orët Javore të zhvilluara nga Studio e Diplomës:  $(55 - 7) / 12 = 4$  orë / javë

5. Teza e diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti apo studimi me karakter përgjithësues në fushat e Arkitekturës dhe disiplinave të lidhura drejtpërdrejtë me formimin e marrë gjatë zhvillimit të programit të studimit.

Teza e diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit e të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore e projektuese, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për të kryer studime e projektme në fushën e Arkitekturës.

Teza e diplomës është e lidhur me disa disiplina të përafërta dhe mund të jetë individuale ose kolektive (dy-tre studentë), në rastet e tezave studimore komplekse. Në rastet e punimeve kolektive, studentët kanë të ndarë çështjet që do të trajtojnë, duke respektuar një ndarje afërsisht të barabartë të volumit të punës që do të kryejnë.

Temat për tezat e diplomës orientohen dhe miratohen nga Studioja e Diplomës e ngritur nga DA. Studiot hartojnë fushat e kërkimit të cilat shërbejnë si udhëzues për propozimet e temave.

Diplomantët paraqesin për miratim kërkesat me temat e propozuara si dhe udhëheqësin. Formulari i propozimit të temës dhe udhëheqësit duhet të jetë i shoqëruar me një dokument 1-2 faqe A4 ku specifikohet dhe argumentohet propozimi, këndvështrimi i diplomantit dhe pritshmërinë në realizimin e temës. Ky dokument duhet të jetë i firmosur nga diplomanti dhe udhëheqësi.

Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, si dhe udhëheqësin e tij. Studioja e diplomës shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i orientuar dhe harmonizuar ato me fushat e kërkimit, pa cenuar nivelin e cilësinë e punimeve të diplomave.

6. Teza e diplomës zhvillohet nën mbikëqyrjen e Studios së Diplomës. Udhëheqësi dhe Studioja e Diplomës janë përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e temës dhe procesit të diplomimit. Diplomanti zgjedh një Udhëheqës në Departament ose jashtë tij i cili miratohet nga Drejtuesi i Departamentit. Kriteret që duhet të përmbushë Udhëheqësi i diplomës vendosen nga DA. Udhëheqësi duhet të shprehë pëlqimin me shkrim për udhëheqjen e temës së diplomës.

- a) Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së diplomantit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të përfundimit të çdo pike të programit. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sesionin normal të mbrojtjes së diplomës.
  - b) Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilit konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit.
  - c) Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit. Ai jep mendimin e tij me shkrim, ku deklorohet realizimi i programit të punës të tezës së diplomës, niveli cilësor, elementët e punës krijuese të studentit dhe lejimi i mbrojtjes së punimit.
7. Studioja e Diplomës është organizuar në grupe pune me 15-25 diplomantë të asistuar dhe mbikëqyrur nga 3-4 pedagogë. Kjo studio kryen aktivitetin e saj sipas programit dhe planit mësimor. Çdo javë studentit paraqet ecurinë e punës së tij në Studion e Diplomës. Studioja ka për qëllim të:
- a) Miratojë temën e diplomës
  - b) Miratojë programin e punës të diplomantit
  - c) Të asistojë udhëheqjen e diplomës
  - d) Të vendosë kritere specifike për tema diplome me kompleksitet apo përmbajtje të veçantë
  - e) Të rekomandojë literaturën për thellimin teorik
  - f) Të mbikëqyrë çdo javë ecurinë e diplomës
  - g) Të rekomandojë ndryshime nëse gjykohet e nevojshme
  - h) Të ofrojë konsulencë të specializuar në fusha specifike
  - i) Të organizojë tre kontrollet e diplomës

Studentit ndjek Studion e Diplomës çdo javë gjatë semestrit X dhe është i detyruar të frekuentojë 75% të seancave në këtë Studio. Nëse studentit nuk përmbush masën e përcaktuar të frekuentimit, duhet të frekuentojë Studion e Diplomës në vitin pasardhës. Njëkohësisht studentit ndjek programin e punës dhe grafikun e konsultimeve me udhëheqësin.

Studioja e Diplomës organizon tre kontrolle periodike, në të cilat kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e saj. Studentit dhe udhëheqësi duhet t'i marrin parasysh rekomandimet e komisionit të kontrollit.

**Kontrolli i parë vlerësohet me notë dhe shlyhet në fund të semestrit IX me përfundimin e modulit “Metoda të kërkimit të aplikuar në arkitekturë”. Me shlyerjen e këtij kontrolli realizohet edhe miratimi i temës së diplomës**

Studentit që nuk mund të shlyejë dy kontrollet e para brenda procesit mësimor të Studios së Diplomës duhet të frekuentojë këtë studio përsëri në vitin pasardhës.

Studentit që nuk mund të shlyejë kontrollin e tretë brenda procesit mësimor të Studios të Diplomës mund ta shlyejë atë në sesionin e vjeshtës ose në sesionet e vitit akademik pasardhës.

**Nëse kontrolli i tretë nuk shlyhet as në këto sesione, studentit duhet t'i përgjigjet kërkesave të ndryshuara që mund të lindin si pasojë e përditësimit periodik të kurrikulës.**

Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës, ka ndjekur Studion e Diplomës dhe ka shlyer të tre kontrollet e detyrueshme.

Drejtuesi i departamentit plotëson fletën e kontrollit të tezës së diplomës, në të cilën regjistrohen kontrollet e kryera dhe vlerësimet për secilin prej tyre.

8. Kalendari i aktiviteteve të Studios së Diplomës përcaktohen në silabusin e lëndës, që hartohet nga Drejtuesi i Departamentit.

Përmbajtja e kontrolleve

Nëse teza e diplomës bazohet në zhvillimin e një projekti, përmbajtja e fazave të kontrollit është si më poshtë:

#### **Kontrolli i parë**

**Kontrolli i parë zhvillohet në përfundim të modulit përgatitor “Metoda të kërkimit të aplikuar në arkitekturë” në fund të semestrit IX dhe vlerësohet me notë. Në këtë kontroll diplomanti duhet të paraqesë:**

- Propozimi dhe argumentimi i temës
- Detyra e projektimit dhe programi i detajuar (me sipërfaqet përkatëse)
- Baza hartografike
- Shembuj studimorë
- Baza teorike – Referenca dhe bibliografi

#### **Kontrolli i dytë**

Në këtë kontroll diplomanti duhet të paraqesë:

- Analiza arkitektonike, historike, social-kulturore, urbane-hapësinore, ambientale
- Konkluzionet e analizës
- Propozimi konceptual – ideor (skema, diagrama, makete, përshkrim, etj.)
- Propozimi urban: zgjidhja e hapësirës urbane
- Projekt-idea dhe zgjidhja arkitektonike: zgjidhja kompozicionale dhe funksionale
- Skema dhe zonimi funksional
- Te dhëna metrike
- Paraqitja e propozimit në plan, pamje, prerje, volumetri

#### **Kontrolli i tretë**

Në këtë kontroll diplomanti duhet të paraqesë:

- Relacioni i tezës së diplomës
- Projekti teknik
- Hollësi ndërtimore dhe zgjidhja teknologjike e fasadave
- Koncepte të zgjidhjes strukturore
- Koncepte të zgjidhjes ambientale dhe impiantistikës
- Maket / foto te maketit

*Për projekte me karakter të veçantë, Studioja e Diplomës përcakton përmbajtjen e fazave të kontrollit.*

Nëse teza e diplomës ka përmbajtje teorike-studimore, përmbajtja e fazave të kontrollit është si më poshtë:

### **Kontrolli i parë**

1. Propozimi dhe argumentimi i temës
2. Plani i kërkimit
  - Identifikimi i problemit
  - Qëllimi i studimit
  - Pyetjet e kërkimit
  - Hipotezat
  - Struktura / përmbajtja e kërkimit
  - Rezultatet e pritshme dhe planifikimi kohor
3. Baza teorike

### **Kontrolli i dytë**

1. Analiza e rasteve të studimit dhe gjetjet
2. Skenarë dhe opsione për zgjidhjen e problemit
3. Propozimi përfundimtar
4. Vërtetimi i hipotezave

### **Kontrolli i tretë**

- Drafti i plotë i studimit (Përmbajtja dhe materiali grafik)
- Konkluzione dhe/ose rekomandime

### 9. Mbrojtja dhe vlerësimi i diplomës

Të gjitha tezat e diplomave, para se të lejohen për mbrojtje, miratohen nga Dekani i FAU. Punimi i diplomës mbrohet para një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik i FAU. Në komision mund të ftohen edhe profesionistë apo personalitete të shquara. Komisioni i diplomimit propozohet nga Drejtuesi i DA dhe miratohet nga Dekani i FAU. Mbrojtja e diplomës është publike. Komisioni i mbrojtjes së diplomave përbehet nga 5-7 anëtarë. Secili nga anëtarët ka në dispozicion një vlerësim nga 0-100 pike. Rezultati përfundimtar i diplomës përlogaritet në bazë të mesatares aritmetike të vlerësimit të të gjithë anëtarëve.

Vlerësimi me note bëhet sipas pikëzimit:

- 100 - 95 pikë vlerësohet me notë përfundimtare 10 (dhjetë)
- 94 - 85 pikë vlerësohet me notë përfundimtare 9 (nëntë)
- 84 - 75 pikë vlerësohet me notë përfundimtare 8 (tetë)
- 74 - 65 pikë vlerësohet me notë përfundimtare 7 (shtatë)
- 64 - 55 pikë vlerësohet me notë përfundimtare 6 (gjashtë)
- 54 - 45 pikë vlerësohet me notë përfundimtare 5 (pesë)
- nën 44 pikë vlerësohet me notë negative 4 (katër)

Nota regjistrohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në përfundim të çdo seance mbrojtjeje, në mënyrë publike kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo diplomanti notën, me të cilën është vlerësuar punimi i tij.

### 10. Modalitete

Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar 285 kredite të parashikuara në planin mësimor të programit përkatës të studimit.

## Kriteret e Diplomimit

- Kriteri 1. Frekuentimi dhe vlerësimi pozitiv ne Studion e Diplomës
- Kriteri 2. Shlyerja e tre kontrolleve të diplomës
- Kriteri 3. Vlerësimi pozitiv nga Udhëheqësi
- Kriteri 4. Vlerësimi pozitiv nga Recensenti
- Kriteri 5. Miratimi nga Dekani i FAU
- Kriteri 6. Mbrojtja e tezës së diplomës

### Paraqitja e diplomës

Rregullat e pranimit dhe dorëzimit (formati dhe standardet) të tezës së diplomës me përmbajtje projekt ose temë teorike-studimore përcaktohen nga Departamenti i Arkitekturës bazuar ne standardet dhe rregullat akademike.

Në aneks të kësaj rregulloreje gjenden formularët D1 dhe D2 si dhe udhëzuesi vjetor mbi fushat kërkimore dhe përbërjen e grupeve konsultuese të Studiove të Diplomës

## 11. Kalendar i Studios të Diplomës

### Semestri IX

Moduli përgatitor “Metoda të kërkimit të aplikuar në arkitekturë”

### Sesioni i Dimrit (fundi i semestrit IX)

Studio Diplome Kontrolli I dhe miratimi i temës

### Semestri X

Java 1

4 orë. Studio Diplome

Java 2

4 orë. Studio Diplome

Java 3

4 orë. Studio Diplome

Java 4

4 orë. Studio Diplome

Java 5

4 orë. Studio Diplome

Java 6

4 orë. Studio Diplome

Java 7

4 orë. Studio Diplome

Java 8

4 orë. Studio Diplome

Java 9

4 orë. Studio Diplome Kontrolli II (I ose II)

Java 10

4 orë. Studio Diplome

Java 11

4 orë. Studio Diplome

Java 12

4 orë. Studio Diplome

Sesioni i Verës (fundi i semestrit X)  
Studio Diplome Kontrolli III (II ose III)

## 12. Dispozita kalimtare

Studentët përsëritës që kanë kryer Kontrollin e parë të diplomës përpara vitit akademik 2022-2023 nuk kanë detyrim frekuentimin e modulit “Metoda të kërkimit të aplikuar në arkitekturë”, por duhet të paraqiten për vlerësim me notë me materialet e Kontrollit të parë.

## ANEKS

### UDHEZUES MBI FUSHAT KËRKIMORE TË ATELIEVE

Regjistrimi i studentit në Studion e Diplomës 2019-2020

Departamenti i Arkitekturës

Për vitin akademik 2020-2021, të gjithë studentët që planifikojnë të frekuentojnë studion e diplomës duhet të regjistrohen paraprakisht në njërin prej 4 atelieve të ngritura nga Departamenti i Arkitekturës.

Studentët duhet të njihen me fushat e kërkimit që ofron secila atelie dhe të shprehin interesin e tyre për të propozuar tema diplome që përputhen me këto fusha.

Në bazë të këtij kriteri, studentët do të shprehin preferencat e tyre duke i renditur atelietë nga zgjedhja e parë (me e preferuar), deri tek zgjedhja e fundit.

Preferencat do të dërgohen me *e-mail* në adresën **studiodiplomeXX@yahoo.com** në formatin e mëposhtëm:

#### Emri Mbiemri

Atelietë e diplomës	Preferenca e studentit (shënoni nga 1 ne 4)
Atelie a	
Atelie b	
Atelie c	
Atelie d	

**Aplikimet nisin në datë XX Nëntor 2019 në orën 12.00 në mesditë dhe mbyllen pas 48 orësh.**

Vini re: Aplikimet që mbërrijnë përpara orës 12.00 nuk do të konsiderohen të vlefshme.

Sipas rendit kronologjik të mbërritjes së aplikimeve me *e-mail*, do të përmbushen edhe preferencat e studentëve për përfshirjen në atelietë e përzgjedhura. (*e-maili* i mbërritur i pari ka të drejtë të bëjë zgjedhjen e parë)

Studentët që nuk arrijnë të aplikojnë përmes *e-mailit* do të regjistrohen pa marrë parasysh preferencën e tyre mbi fushën apo atelienë.

Brenda datës **xx nëntor 2019**, Departamenti do të shpallë shpërndarjen e studentëve në atelietë e mësipërme.

Pas regjistrimit në atelie, **studenti** do të përgatisë dhe të dorëzojë në Departament propozimin për temën e diplomës dhe udhëheqësin në përputhje me fushat të cilat mbulon atelieja ku do të ndjekë diplomën.

Verifikimi i plotësimit të kushteve për frekuentimin e diplomës do të bëhet nga sekretaria në fund të semestrit të parë. Studentët që rezultojnë se nuk përmbushin këto kushte nuk do të mund të vijojnë frekuentimin dhe shlyerjen e kontrolleve të semestrit të dytë në atelietë përkatëse.

#### PERSHKRIMI I ATELIEVE TE DIPLOMËS

ATELIE A	ATELIE B	ATELIE C	ATELIE D
Drejtues i grupit <b>L.CAPELI</b>	Drejtues i grupit <b>A.MALIQARI</b>	Drejtues i grupit <b>D.VEIZAJ</b>	Drejtues i grupit <b>F.NEPRAVISHTA</b>

<b>Fusha orientuese</b>	Fusha orientuese	Fusha orientuese	Fusha orientuese
<i>Studime mbi arkitekturën dhe arkitektët modernë në Shqipëri.</i>  <i>Vendet për kulturën dhe spektaklin</i>	<i>Arkitektura e konfliktit</i>	<i>Memoria kolektive. Analize kritike ne leximin e qytetit Identitete dhe kufij</i>	<i>Arkitektura dhe Rijetëzimi i Ndërtesave dhe i Ansambleve Arkitektonike</i>
<i>"Housing", sfidat e reja te problemeve te ardhshme te banimit në vendin tone.</i>	<i>Modele të qëndrueshme të arkitekturës</i>	<i>Arkitektura e lëvizjes</i>	<i>Arkitektura Shekullit të XX në Shqipëri</i>
<i>Rrugët për zhvillimin e strukturave turistike ne realitetin shqiptar dhe rajonal:</i>			<i>Projektimi i Qëndrueshëm dhe Rindërtimi ne rast te fatkeqësive natyrore</i>

ATELIE A
L.CAPELI

## STUDIME MBI ARKITEKTURËN DHE ARKITEKTËT MODERNË NË SHQIPËRI.

Arkitektura moderne në Shqipëri ka kaluar tashmë 100 vite histori, një histori jo e shkruar e cila për tu njohur e trajtuar gjerësisht me të gjitha anët pozitive e negative të saj, duhet studiuar. Qytetet tona nisën modernizimin e tyre me plane urbanë të propozuar nga arkitektë të huaj por shpesh edhe në bashkëpunim me arkitektë shqiptarë. Pjesërisht të aplikuar apo jo, këto plane u bënë sfondi për të ndërtuar veprat e mëvonshme arkitektonike, kryesisht të karakterit privat të tipologjisë së banimit, por edhe të karakterit publik të tipologjive të ndryshme administrative. Në dekadat para çlirimit këto vepra u ndërtuan nga arkitektë të huaj e shqiptarë, ndërkohë që pas çlirimit e deri në vitet '90 çdo objekt u projektua nga arkitektë shqiptarë, fillimisht ndoshta edhe në bashkëpunim me të huaj, por më pas në pavarësi të plotë projektuese. Kemi kështu një gamë të gjërë ndërtimesh të bëra nga arkitektë më shumë apo më pak të njohur, të cilët kanë shënuar mes krijimtarisë së tyre historinë e arkitekturës sonë moderne.

Kjo atelie Diplome ka për qëllim të nxisë studimin e këtyre veprave, ti evidentojë të grupuara në tipologji por edhe të hulumtojë mbi zhvillimin e tyre formal, funksional e stilistik. Këto studime tipologjike duhen parë në kuadrin lokal të zhvillimit arkitektonik të ndërtimeve në Shqipëri por edhe në analizë krahasuese me të njëjtat tipologji të njëkohshme në botë, për të bërë të mundur kështu evidentimin nëse ai ekziston apo jo, të një karakteri lokal arkitektonik të influencuar nga faktorë të brendshëm socio-politikë apo ekonomikë.

Nga ana tjetër Studime të karakterit hulumtues, përshkruar e analizues, mund të përfshijnë aktivitetet krijuese projektuese të arkitektëve Shqiptarë të periudhës së modernizimit në Shqipëri, duke evidentuar kronologjikisht objektet e projektuar, materialet grafike e fotografike të tyre, e nëpërmjet analizës formale e stilistike të deduktohet mbi aktivitetin krijues të arkitektit për të konkluduar në një biografi arkitektonike të tij.

## VËNDET PËR KULTURËN DHE SPEKTAKLIN

Kjo studio diplome propozon një udhëtim ndërmjet reales dhe sureales nëpërmjet realizimit të veprës arkitektonike të dedikuar kulturës dhe spektaklit, si ndërmjetës me rol sublim në emancipimin e shoqërisë metropolitane. Strukturat arkitektonike shihen si një suport i rëndësishëm për rritjen e kualitetit të jetës nëpërmjet trajtimit të nevojës për rekreacion e cila në zhvillimet më të fundme, merr një rëndësi të veçantë në konsolidimin e shoqërisë nëpërmjet mendimit artistik. Guy Debord në librin e tij – Shoqëria e Spektaklit, shpreh: “spektakli nuk është vetëm një bashkësi imazhesh, por një raport social personash i ndërmjetësuar nëpërmjet imazhesh.” Që prej lashtësisë e përgjatë gjithë historisë së arkitekturës perëndimore, është konsideruar si esencial roli emancipues e filtrues i hapësirës arkitektonike e cila ka potencialin për të ndryshuar sjellje e vizione shoqërore. Kjo fuqi e rrallë, jo vetëm imazhistike, por e një dimensionit më të gjerë konceptual, gjendet e ngurtësuar brenda materies së ndërtesave të cilat i dedikohen kulturës dhe spektaklit. Në ato shpesh kondensohet vetë shpirti i epokës dhe esenca e shoqërisë e cila animon hapësirën dhe i jep vitalitet formës statike arkitektonike. Në këtë



këndvështrim produkti duhet të përgjigjet në mënyrë të denjë tendencës, por njëkohësisht duhet të suportojë peshën e një shprehje formale sublimë, pa kohe dhe të përshtatshme ndaj ndryshimeve frenetike që hasen sot në shoqërinë bashkëkohore.

Konkretisht, pjesë e kesaj studio diplome do të jenë tema të cilat trajtojnë objekte që lidhen me kulturën dhe artin duke mos u kufizuar por, duke përfshirë gamën më të gjerë të tyre. Në këtë kuptim do të trajtohen tipe me tradicionale të shprehjes kulturore si teatro, opera, muze, biblioteka, shkolla arti dhe muzike, ashtu sikur edhe tendenca të mëvonshme të objekteve më eksperimentale, të cilat shkojnë drejt një përzierje më komplekse programatike siç mund të jenë qendrat kulturore multidisiplinore.

Studenti do të përshkojë një itinerar projekti që kalon përmes analizës së qytetit deri në përcaktimin e kontekstit të duhur të ndërhyrjes, studime që lidhen me tendencën dhe frymën e zhvillimeve kulturore dhe arkitektonike bashkëkohore, për të kaluar më pas në formulimin e zgjidhjes dhe deri detajimin e propozimit arkitektonik.

## "HOUSING", SFIDAT E REJA TE PROBLEMEVE TE ARDHSHME TE BANIMIT NË VENDIN TONE.

Në përputhje me ecurinë e pamatshme të zhvillimit të qyteteve dhe sidomos ndërtimeve të banimit (banesat) del urgjente që në pikëpamje studimore të krijohet një tablo e zhvillimeve sasiore, zhvillimeve hapësinore në territorin brenda dhe jashtë qyteteve në vendin tonë, zhvillimeve tipologjike dhe morfologjike që mbizotërojnë, dhe kanë perspektive zhvillimi për vitet që vijojnë.

Temat e diplomave, qofshin studimore po ashtu dhe projektuese duhet të kenë në fokus evidentimin e fenomenit "Housing" në Shqipëri me të mirat dhe të këqijat e tij, veçoritë në përsëritjen e rrugëve të njohura botërore, si dhe veçoritë në bumin e banesave në realitetin kaotik shqiptar.

Për efekt të studimit dhe klasifikimit mendojmë se është e nevojshme të orientohet studimi në grupe morfologjike si dhe në forma përhapjeje në strukturën e qytetit (qendër-periferi):

- Zhvillimet e banimit shumëkatësh, aktualitete, tendenca dhe kufizimet në realitetin tonë të ardhshëm.
- Zhvillimet e banimeve të ulëta (low rise housing), fillesat dhe kushtet e ardhshme për zhvillim
- Programet funksionale dhe ekonomike të banesave popullore si dhe banesave me kushte të avancuara ekonomike.
- Zhvillimet e fenomenit "Housing" në reflektimin drejt banesave me përdorim miks (përdorim banimi dhe përdorim publik) si formë eksperimentale dhe bashkëkohore në zhvillimet brenda qyteteve sot.
- Kërkimi për gjetjen e rrugëve të identifikimit lingvistik arkitekturor në banesat në zonat e ndryshme klimatike (bregdetare, kodrinore, malore)
- Reflektimi i kërkesave të shtetit në zhvillimet e banimit në të ardhmen.
- Roli i ndërtimeve informale në strukturat e banimit urban, gjetja e rrugëve për formalizimin në të ardhmen, problem themelor i habitatit kombëtar.

Tematikat e kërkuara siç shikohen trajtohen në kushtet kur akoma nuk kemi konkluzione paraprake për problemin "Housing" në rang kombëtar.

Kjo është edhe arsyeja që në tematikat e mësipërme nuk përjashtohen por presupozohen të studiohen në sintezë me sa më sipër dhe problemet në këndvështrimin e politikave shtetërore, financiare e legjislative, planifikuese urbane, duke e parë zhvillimin e arkitekturës së "Housing" të pa shpërndarë nga këta faktorë.

## RRUGËT PËR ZHVILLIMIN E STRUKTURAVE TURISTIKE NE REALITETIN SHQIPTAR DHE RAJONAL:

Zhvillimet turistike kërkojnë urgjentisht një kapje të problematikës urbane dhe arkitektonike nëpërmjet studimeve dhe projekteve eksperimentale në kohën e zhvillimit tranzitor dhe në hapësirën rajonale ku jetojmë duke kuptuar se me aq sa kemi ndërtuar ne jemi futur në procesin e zhvillimeve të ambientit të ndërtuar, të natyrës turistike me prishje dhe pak harmoni me natyrën dhe historinë.

Temat e diplomave duhet të analizojnë shkallën e zhvillimit ndërtimor, shkallën e ndërhyrjes në mjedis, problematikën menaxhuese dhe administruese në kushtet e një ekonomie private liberale por dhe të kontrolluar.

Mendojmë se tematikat mund të grupohen si më poshtë:

Zhvillimet e ndërtimeve turistike në pikëpamjen sasiore, impakti aktual dhe perspektiv- ekonomik, format legjislative dhe financiare në stimulimin e programeve të mëdha kombëtare dhe lokale. Kjo tematike nuk duhet të bjerë në rutinën e analizave social-ekonomike pa u ndërthurur me tematikën e identifikimit të strukturave ndërtimore dhe arkitektonike me efekt pozitiv dhe negativë në ambient.

Gjetja e formave të strukturave turistike në përputhje me madhësinë dhe veçorinë e qyteteve, vendbanimeve, dhe pikave turistike me rëndësi kombëtare dhe lokale.

Orientimi dhe zhvillimi i strukturave urbane të vetë-zhvilluara në funksion të turizmit, bregdetar dhe malor. Faktorët gjenerues, shtytës dhe orientues në një proces të tillë të planifikimit të urbanizimit vetë veprues, arkitekturës vernakulare.

Analizat e zhvillimeve konceptuale për gjetjen e veçorive dhe identiteteve lingvistike të strukturave turistike formale dhe informale në kushtet kombëtare dhe mesdhetare.

Kërkimet në gjetjen e strukturave dhe teknologjive ndërtimore që lidhen me traditën dhe e modernizojnë atë.

Analizat e zhvillimit të fenomenit turistik në të gjitha fazat duhet të bashkë-shoqërohen ngushtësisht me analizat e ruajtjes dhe zhvillimit të mjedisit.

Tematikat studimore dhe projektuese duhet të përcaktojnë mirë faktorët e qëndrueshëm natyror dhe urban ekzistues të cilat janë faktorë të përhershëm gjenerimi dhe përcaktojnë mundësitë e zhvillimit në të ardhmen.

Orientimi problematik i mësipërm nuk duhet të pengojë imagjinimin e projekteve dhe studimeve që zhvillojnë si strukturat turistike popullore të rekreacionit masiv, pa përjashtuar strukturat elitare turistike si hotelet, resortet, fshatrat turistike etj.

ATELIE B
A.MALIQARI

## ARKITEKTURA E KONFLIKTIT

Arkitektura mbetet dëshmia më e dukshme e zhvillimit të një shoqërie. Qytetet, si forma më komplekse e ambientit të ndërtuar nga njeriu, janë organizma ku mbivendosen shtresat historike e arkitektonike të periudhave të ndryshme dhe ku konflikti mes të shkuarës e të tashmes mbetet thelbi i zhvillimit të fenomeneve urbane.

Pikërisht në këtë luftë të vazhdueshme në organizmin urban shtrihet fusha e kërkimit të kësaj studioje diplome ku objektivi kryesor lidhet me konfliktin në arkitekturë, si një fenomen që gjeneron identitetin e qyteteve të së nesërme.

Konflikti në arkitekturë duhet kuptuar si nevoja për të dominuar përmes formës së ndërtuar dhe kjo nevojë shfaqet dukshëm në momente kyçe historike të tranzicionit politik, ideologjik apo ekonomik të një vendi. Nevoja për të konfirmuar të ardhmen mbi të shkuarën krijon tensionin dhe konfliktin urban, ku arkitektura shndërrohet në mjet për të shpërfaqur forcën e vizionin dhe njëkohësisht për të ushqyer propagandën.

Që prej themelimit të shtetit shqiptar, arkitektura nuk ka mundur për asnjë çast të shkëputet nga konflikti, duke qenë gjithmonë gjenerues dinamikash apo debatesh të mprehta të cilat prodhojnë mjedise urbane të pazakonta me impulse të larta zhvillimi. Pikërisht në përballje me të shkuarës dhe të tashmes, kërkimi do të tentojë të evidentojë apo të gjenerojë trajta të bashkekzistencës të arkitekturës apo hapësirës publike. Në këtë kontekst, **marrëdhënia me qytetin historik dhe trashëgiminë, qytetin socialist dhe ideologjinë si dhe dinamikat e sotme politike dhe ekonomike të zhvillimit do të jenë gjeneruesit e tematikave të projekteve dhe kërkimit** që do të zhvillohen nga diplomantët. Konflikti do të jetë baza e diskutimit përmes të cilit propozimet e diplomantëve do të përballen me qytetin me qasje që shtrihen **mes sfidës dhe utopisë**.

Tema specifike për tu zhvilluar përmes projektit dhe / apo kërkimit të diplomës mund të fokusohen në:

1. *Propozime të reja arkitektonike të vendosura në kontekste historike.*
2. *Ndërhyrje arkitektonike apo urbane në ndërtesa dhe hapësira publike ekzistuese.*
3. *Propozime për simbole të reja urbane.*
4. *Retushimi i imazhit të qytetit.*

## MODELE TË QËNDRUESHME TË ARKITEKTURËS

Zhvillimi i qëndrueshëm mundëson përmeshjen e nevojave për gjeneratat e sotme, pa privuar gjeneratat e ardhshme nga e njëjta e drejtë. Thelbësore për këtë koncept, është ruajtja e balanceve dhe sistemeve natyrore mbi të cilat varen ekonomia dhe shoqëria.

Në këtë kuadër, arkitektura dhe qytetet janë ndër faktorët bazë që duhet të ri-dimensionojnë modelet e ofruara. Eksperiencia e deritanishme vlerësohet si një model i dështuar i cili ka nevojë emergjente për tu ri-konceptuar në kërkim të qasjeve me ndjeshmëri të lartë kundrejt habitatit.

Mbështetur në frymën e “Akhenda e Re Urbane - Deklarata e Kuito-s mbi qytete të qëndrueshme dhe vendbanimet për të gjithë” (<http://habitat3.org/wp-content/uploads/NUA-Albanian.pdf>) të Kombeve të Bashkuara (UN Habitat III, 2016), kërkimi mbi **modele të reja të qëndrueshme zhvillimi nga shkalla arkitektonike e deri në atë të vendbanimeve dhe territorit** mbetet një sfidë sa globale po aq e lidhur ngushtë me kontekstet specifike lokale. Janë pikërisht këto modele zhvillimi, të reja e të përgjegjshme kundrejt kontekstit dhe sfidave të së ardhmes, që synojnë të jenë thelbi i kërkimit të studios së diplomës.

*Kërkimi do të mbështetet në vizionin e qyteteve për të gjithë, duke iu referuar përdorimit të barabartë dhe të qëndrueshëm të qyteteve dhe vendbanimeve, duke synuar të promovojë përfshirjen dhe duke siguruar që të gjithë banorët e brezave të sotëm dhe të ardhshëm, pa asnjë lloj diskriminimi, të jenë në gjendje të jetojnë dhe të krijojnë qytete dhe vendbanime të përshtatshme, të sigurta, të shëndetshme, të arritshme, rezistente, dhe të qëndrueshme, si një e mirë e përbashkët që në thelb kontribuon për prosperitetin dhe cilësinë e jetës për të gjithë.*

*Në kërkimin arkitektonik synimi është për të zhvilluar modele ndërtimi dhe ndërtesa të qëndrueshme, të rinovueshme, ndërtime dhe mënyra ndërtimi me energji eficiente e që kontribuojnë në mirëqenie dhe në përmirësimin e shëndetit publik.*

Përmes projekteve apo kërkimit diplomatët do të inkurajohen të propozojnë modele arkitektonike e urbane të qëndrueshme, ku fokusi përtej dimensionit ambiental, do të jetë në modelin social, kulturor dhe ekonomik.

Tema specifike për tu zhvilluar përmes projektit dhe / apo kërkimit të diplomës mund të fokusohen në:

1. *Modele jetese, urbane e ndërtimi duke iu referuar parimeve të qëndrueshmërisë ambientale. Studenti mund të zhvillojë kërkim metodologjik me fokus në parimet e qëndrueshmërisë për të prodhuar modele inovative ndërtesash apo të hapësirës urbane.*
2. *Ndërtesa të qëndrueshme, të cilat përdorin sisteme e teknologji pasive dhe burime energjie të rinovueshme. Studenti mund të fokusohet në projektimin e ndërtesave të reja apo rehabilitimin e atyre ekzistuese ku qëllim parësor mbetet performanca ambientale e ndërtesës.*
3. *Mënyra ndërtimi dhe qasje projektuese, që kontribuojnë në mirëqenie, me kosto sa më të ulët ndërtimi dhe / apo shfrytëzimi të objekteve. Studenti mund të fokusohet në tekonikën e materialeve, ciklin e jetës dhe përdorimin / ripërdorimin e tyre si dhe në teknologjitë e aplikuar në ndërtesat me eficientë energjie.*
4. *Ndërtesa me kompleksitet të lartë të skemës funksionale dhe teknologjike. Studenti mund të fokusohet në impaktin ambiental dhe marrëdhënien me mjedisin natyror dhe / apo kontekstin urban.*

ATELIE C
----------

D.VEIZAJ
----------

## MEMORIA KOLEKTIVE. ANALIZE KRITIKE NE LEXIMIN E QYTETIT IDENTITETE DHE KUFIJ

Shprehjet e transformimeve kulturore ne ambientin fizik te ndërtuar (duke iu referuar qasjes se *Deleuze*) mbeten një temë komplekse e cila gërsheton elemente te lidhura me memorien kolektive si konstrukt social, me identitetin hapësinor apo me atë metaforik te kufirit. Ndërkohë N. Ellin, ne një qasje mbi post-modernizmin e rendit kufirin si metaforën pasardhëse, pas asaj te kolazhit, mbi te cilën enden qytetet bashkëkohore si realitetet fizike e te paprekshme ne te njëjtën kohe. Objekti i kësaj studioje është te kthehet ne një ftese për kërkuesin e studentin diplomat njëkohësisht, te eksplorojë kontekstin shqiptar, si një realitet i ndërtuar *mes kufijsh*, përmes optikës se identitetit e memories.

Përmes propozimeve me specifike qe diplomanti do te sjellë, synohet përballja me *sub-tema* me specifike, si kontributi i shkalles hapësinore ne identitet, refleksione mbi marrëdhënien e tipologjisë arkitektonike e kontekstit, apo pasqyrimet e *lifestyle-it* ne ambientin fizik te ndërtuar etj.

Mjeti eksplorues i fushës mbetet fleksibël, qe nga projekti arkitektonik si sublimim i një procesi kompleks krijues, deri tek *te shkruarit*, si forma me ortodokse e kërkimit teorik.

## ARKITEKTURA PËR LËVIZJEN

Kjo fushe tenton të përfshijë departamentin si njësi kërkimore ne probleme me kontekstuale, ku strategjia mbi lëvizjen e transportit ka marre një peshe specifike ne realitetin shqiptar, si një vend ne transformim te vazhduar.

Synimi i ateliesë se diplomës, tenton te ezaurojë ne shkalle arkitektonike problematiken e hedhur nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar si dhe strategji sektoriale lidhur me fushën.

Objekti i ateliesë tenton thellimin teorik mbi çfarë tipologjitë arkitektonike lidhur me lëvizjen e transportin përfaqësoj nëpër qytetin bashkëkohor dhe për profilin e individit bashkëkohor. Përmes propozimeve me konkrete te diplomanteve e konsulentëve, synohen thellime mbi tema me specifike si evoluimi tipologjik dhe roli i teknologjive digjitale ne këtë proces, roli i dizajnit arkitektonik ne trajtimin e gjurmëve infrastrukturore ne territor, apo ne forma te ndryshme te habitatit apo mbi raporti i këtyre objekteve ne raport me qytetin nëse pretendohet dialog apo dominim.

Mjeti eksplorues i fushës mbetet fleksibël, qe nga projekti arkitektonik si sublimim i një procesi kompleks krijues, deri tek *te shkruarit*, si forma me ortodokse e kërkimit teorik.

ATELIE D

F.NEPRAVISHTA

## ARKITEKTURA DHE RIJETËZIMI I NDËRTESAVE DHE I ANSAMBLEVE ARKITEKTONIKE

Ateleja e Diplomës synon të trajtojë çështjen e rijetëzimit dhe rigjenerimit të trashëgimisë ekzistuese të ndërtesës, një nga çështjet më të rëndësishme në panoramën e arkitekturës bashkëkohore, veçanërisht në lidhje me kontekstin Shqiptar.

Ateleja e Diplomës dëshiron të veprojë kryesisht si një mundësi për reflektim pjesëmarrës dhe shume disiplinor - duke pasur si qëllim ne vetvete projektin e arkitekturës - për te projektuar përmes përcaktimit të një kornize kritike metodologjike, brenda së cilës studenti mund të identifikojë një strategji të pjekur dhe aktuale që synon rijetëzimit e ndërtesave ekzistuese dhe i ansambleve arkitektonike te degraduara.

Ateleja e Diplomës do të adresojë çështjen e përgjithshme të rimëkëmbjes së ekzistueses në Arkitekturë, si brenda traditës Shqiptare të ndërtimit të orientuar historikisht drejt ripërdorimit, ashtu edhe në lidhje me prirjet më të përparuara të arkitekturës bashkëkohore që kushtojnë një vëmendje e veçantë temës të riciklimit krijues dhe dialektikës midis arkitekturës ekzistuese dhe asaj të re. Në veçanti, ateleja do t'i drejtojë studentët të reflektojnë mbi implikimet arkitektonike të një game te gjere objektesh dhe situatash urbane te trashëgimisë sonë te ndërtimit.

Ateleja do t'i drejtojë studentët të reflektojnë mbi implikimet arkitektonike të një projekti rijetëzimi në drejtim të përdorueshmërisë, qëndrueshmërisë teknike dhe formale, komfortin, zhvillimit të qëndrueshëm dhe ruajtjes se ambientit për të zhvilluar aftësi në lidhje me një temë që do të përbëjë një mundësi të rëndësishme pune projektimi për një arkitekt.

## ARKITEKTURA SHEKULLIT TË XX NË SHQIPËRI

Ateleja e Diplomës synon të hedh dritë mbi një temë te një interesi të madh në ditët e sotme në lidhje me trashëgiminë e shekullit te XX ne vendin tone.

Hulumtimi përqendrohet ne analizimin e rasteve të ndryshme te tipologjisë së arkitekturës totalitare të ndërtuara në Shqipëri. Historia e aktiviteteve te projektimit dhe ndërtimit që kontribuojnë në formimin dhe transformimin e mjedisit, në lidhje me kornizën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të epokave të ndryshme dhe në marrëdhëniet në mes të qytetërimeve të ndryshme. Në veçanti, aspektet në lidhje me përfaqësimin e hapësirës arkitektonike, teknikat, materialet e ndërtimit dhe organizimin e sheshit të ndërtimit; historia e mendimit dhe teoritë mbi arkitekturën dhe qytetin; studimi kritik i veprës arkitektonike, i shqyrtuar në kontekstin e saj duke iu referuar shkaqeve, programeve dhe përdorimit, në modalitetet e saj gjuhësore dhe teknike, në realitetin e saj ekonomik dhe material dhe në kuptimet e saj kulturore.

Temat e kërkimit mund te përfshijnë një nga fashat kohore:

1. Arkitektura në periudhën 1924-1939
2. Arkitektura në periudhën 1939-1944
3. Arkitektura në periudhën 1945-1990
4. Arkitektura në periudhën e tranzicionit mbas vitit 1990.

Drejtimet e projektit kërkimor:

- Analizimi se si zhvillimi i arkitekturës së ndërtuar në Shqipëri u ndikua nga ideologjia e kohës dhe se si u mbështet dhe zhvillua nga arkitektët.
- Hulumtimi në arkivat e ndërtimit, përshkrimi dhe prezantimi i projekteve origjinale të projektimit të arkitekturës totalitare sipas periudhave.
- Hulumtimi në terren dhe analizimi i objekteve të ndërtuara.
- Evidentimi i vlerave, ruajtja dhe rehabilitimi i tyre.

## PROJEKTIMI I QËNDRUESHËM DHE RINDËRTIMI NE RAST TE FATKEQËSIVE NATYRORE

Atelieja e Diplomës synon të trajtojë çështjen e projektimit të qëndrueshëm dhe rindërtimit në rast të fatkeqësive natyrore.

Katastrofat mund të jetë katalizator për ndryshime pozitive. Gama e rreziqeve mjedisore përfshin fenomene gjeofizike si tërmete, rrëshqitje toke, përmbytje të shpejta, tsunami dhe shpërthime vullkanike; katastrofat teknologjike që përfshijnë aksidente kimike dhe derdhje; dhe problemet mjedisore që zgjasin në kohë (p.sh., thatësira, erozioni dhe ndryshimi i klimës).

Historia ka demonstruar se katastrofat u kanë dhënë disa qyteteve një shesh të zbrazët për të rindërtuar sipas një plani më të qëndrueshëm: Çikago pas Zjarrit të Madh, Halifax pas Shpërthimit ose Varshavë pas Luftës së Dytë Botërore. Fatkeqësitë natyrore mund të ofrojnë këtë lloj mundësie. Megjithatë, në panik dhe dëshpërim pas një fatkeqësie natyrore, ka një presion për të vepruar sesa për të reflektuar. Planifikimi strategjik shpesh i lëshon vendin veprimit të fragmentuar. Projektet e rindërtimit shpesh arrijnë vetëm të rikthejnë status quo-në, në vend që ta përmirësojnë atë.

Atelieja e Diplomës synon në fitimin e një rruge projektimi resiliante[1] dhe të qëndrueshëm të arkitekturës për t'iu përgjigjur katastrofave dhe fatkeqësive natyrore dhe atyre të bëra nga njeriu - si dhe ndryshimeve afatgjata që rezultojnë nga ndryshimi i klimës. Një qasje e qëndrueshme për projektin e rindërtimit pas katastrofës duhet të adresojë jo vetëm nevojat e mjedisit të ndërtuar, por edhe ekosistemin, kërkesat socio / kulturore dhe të infrastrukturës. Miratimi i këtij kuadri siguron që rindërtimi të mos ketë ndikim negativ në aspektet e tjera të shëndetit dhe mirëqenies afatgjatë të rajonit. Ruajtja e një ekuilibri delikat të projektit midis qëllimeve natyrore dhe sociale/ekonomike do të sigurojë gjithashtu që komunitetet të koordinojnë burimet e disponueshme dhe të mbajnë mundësi të drejta dhe të barabarta për të gjithë aktorët në procesin e rindërtimit.

---

[1] Projektimi resiliant është një qasje e re ndaj projektimit, ndërtimit dhe funksionimit të ndërtesave. Qëllimi i tij është të krijojë struktura që i rezistojnë katastrofave natyrore dhe të bëra nga njerëzit, si dhe të sigurojnë rindërtim të shpejtë.